



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIRO KASTËR
SENATI AKADEMIK

Nr. 517 Prot

Datë 19/04 2023

VENDIM

Nr. 20, datë 19.04 2023

**PËR AKORDIMIN E TITULLIT AKADEMIK "DOCTOR HONORIS CAUSA" Z.
TRIANTAFYLLOS A.D. ALBANIS**

Mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 112, datë 23.02.2018 "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standarteve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i asociuar" dhe "Profesor", kreu V pika 1; ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38 pika 3; Statutin e Universitetit "Eqrem Çabej, neni 19 pika 9, Senatit Akademik në mbledhjen e të datës 19.04.2023 shqyrtoj kërkesën e një grupi senatorësh, protokolluar me nr. 31, datë 11.1.2023, për akordimin e titullit akademik "Doctor Honoris Causa" z. Triantafyllos A.D. Albanis. Pasi konstatoj se ish-in respektuar të gjitha procedurat ligjore: kërkesa drejtuar MAS nr. 43, datë 16.01.2023 për dhënie pëlqimi për akordim titulli "Doctor Honoris Causa"; informacion dërguar MAS nr. 101, datë 23.01.2023 në mbështetje të kërkesës të sipërpërmendur; dhënje pëlqimi nga MAS me shkresën nr. 302/1, datë 07.2.2023 për akordimin e titullit "Doctor Honoris Causa" z. Triantafyllos A.D. Albanis, me shumicën absolute të të gjithë anëtarësisë,

VENDOSI

1. T'i akordohet titulli akademik "Doctor Honoris Causa" z. Triantafyllos A.D. Albanis, me motivacionin:

“Personalitet me aftësi të spikatura drejtuese e kontribute gjurmëlënëse për të menaxhuar ndryshimet në botën akademike dhe më gjerë; burim frymëzimi dhe lider në kërkimin e zgjidhjeve inovative për ngjarjet e rëndësishme të kohës së sotme; misionar në ndërtimin e një bote më të mirë dhe më të zgjuar; me kontribut të veçantë për përafrimin e standarteve të Universitetit “Eqrem Çabej” me ato të hapësirës evropiane”

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof.dr.Bektash MEMA

